

# **PARTIA TURKE E DREJTËSISË SË KOSOVËS**

## **Statuti**

### **DËSPOZITAT E PËRGJËTHSHME**

#### **Neni 1**

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës është parti politike, parimi i së cilës është pikëpamja politike shoqërore. Kjo parti politike, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, gjininë, besimin, ngjyrën, traditat dhe zakonet e qytetarëve, është e hapur për të gjithë ata që e pranojnë Programin dhe përkufizimet ligjore të këtij subjekti, e që duan të anëtarësohen në të, për të kontribuar në realizimin e synimeve të Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës .

#### **Neni 1 Objektivat themelore**

- 1.1- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës është subjekt politik, i themeluar për t'u organizuar dhe për të vepruar në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; të dokumenteve dhe të instrumenteve ndërkombëtare, të pranuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës; të Ligjit për Financimin e Partive Politike; të Ligjit për zgjedhje; dhe të legjislacionit tjetër relevant.
- 1.2- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , “vullnetin kombëtar” e konsideron fuqi të vetme përcaktuese; mbron parimin e mbizotërimit të ligjit, të fuqisë, e cila është mbi individët dhe mbi institucionet që në emër të kombit e gëzojnë të drejtën e sovranitetit; miraton që mendja, dija dhe eksperiencia janë udhërrëfytes. Pranon se vullneti kombëtar, mbizotërimi i ligjit, mendja, dija, eksperiencia, demokracia, të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe etika individuale, janë referencat themelore të botëkuptimit të udhëheqjes politike. Beson se sovraniteti

i vullnetit kombëtar mund të arrihet vetëm me gëzimin e të gjitha të drejtave politike, në një rregull demokratik pluralist dhe pjesëmarrës.

- 1.3- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , mbron integritetin e pandashëm të Kosovës. Pranon rrafshin e jetës politike, me qëllim të arritjes në nivelin e qytetarisë bashkëkohore, duke mbrojtur vlerat që burojnë nga e kaluara.
- 1.4- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, është parti politike me “njeriun” në qendër. Beson se shërbimi më i lartë, është shërbimi për njeriun. Synimin e aktivitetit të saj e përbëjnë: lumturia, qetësia, siguria dhe shëndeti i njeriut.
- 1.5- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, mbron idenë se e drejta e njerëzve për të jetuar sipas besimit të tyre dhe shprehja e lirë e mendimit, janë të padiskutueshme.
- 1.6- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës e pranon njeriun si synim dhe si bazë të zhvillimit ekonomik. Si problem më të rëndësishëm socio-ekonomik të Kosovës e konsideron pabarazinë e të ardhurave dhe papunësinë. Angazhohet për punësimin e të rinjve dhe të të papunëve.
- 1.7- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës e konsideron familjen themel të shoqërisë. Beson se familja, e cila luan rolin e urës ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes, është organizimi i pazëvendësueshëm shoqëror për bartjen e vlerave kombëtare të turqve të Kosovës, për ndjenjat, për mendimet dhe për traditat e zakonet e tyre. Angazhohet që çdokush dhe posaçërisht të rinjtë të jetojnë në siguri e të zhvilluar dhe të nivel të lartë të mirëqenies. Për këtë arsye, synon vënien në praktikë të një botëkuptimi të arsimimit, me qëllim të formimit të një shoqërie të dijes, të pajisur me mjete dhe me informacione shkencore.
- 1.8- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës i çmon tiparet e demokracisë pluraliste e përfaqësuese, pjesëmarrëse dhe konkurruese. Beson që shoqëria civile është e pazëvendësueshme në jetësimin e këtyre tipareve dhe në themelimin e një administrate publike efektive, cilësore e të mbikëqyrur.

- 1.9- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës beson në drejtësi; angazhohet për eliminimin e pengesave që pengojnë mbizotërimin e të drejtëve në çdo punë dhe aktivitet; angazhohet për gjykim të drejtë dhe për jetësimin e lirisë për të kërkuar drejtësi. Në këtë mënyrë, synon mbrojtjen, pavarësinë dhe natyrën unitare të shtetit të Kosovës.
- 1.10- Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të institucionalizohet me kuadro cilësore dhe të specializuara në lëmenj të ndryshëm, në mënyrë që, në të ardhmen, partia të jetë më e fuqishme.

### **Parimet e përgjithshme**

Statuti dhe Programi i partisë janë të obligueshëm për të gjithë anëtarët, dhe për kryetarin e partisë. Anëtarësimi dhe marrja e përgjegjësisë në parti, do të thotë të pranosh synimet dhe objektivat e partisë dhe të angazhohesh për jetësimin e këtyre synimeve në kuadër të mundësive dhe të shkathtësive. Asnjë zyrtar i partisë nuk mund të veprojë dhe të përfshihet në aktivitete në kundërshtim me synimet dhe me objektivat e partisë. Çdo anëtar i partisë, duke marrë pjesë në veprimtari partiake, ka të drejtë t'i zhvillojë njohuritë dhe shkathtësitë jetësore, politike dhe shoqërore, dhe ka të drejtë që këto njohuri dhe shkathtësi t'i bartë në jetën politike.

Për ndarjen e përgjegjësive partiake dhe atyre në zgjedhje, do të merren parasysh parimet e demokracisë partiake dhe parimet e të drejtës së anëtarësisë. Kriteria themelore do të jenë: merita, aftësia dhe siguria.

### **Neni 2**

Emërtimi i partisë së themeluar, sipas këtij Statuti, është: KOSOVA ADALET TÜRK PARTISI (Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ).

Akronimi i emërtimit është: KATP.

Selia e Partisë Turke të Kosovës për Drejtësi është në Mamusha.

Vula e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës është në gjuhën turke dhe mund të përkthehet në gjuhët që përdoren në Kosovë. Vulat do të jenë në formë katrore dhe në formë të rrumbullakët.

Emblema e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të jetë harta e Kosovës brenda shtate gjysmëhënavë të bardha, mbi sfondin e kuq.

### **Neni 3**

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ka cilësinë e personit juridik.

### **Neni 4**

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës vepron në gjithë territorin e Kosovës.

Veprimtarinë e saj e shtrin në gjitha fushat e interesit të përbashkët të komunitetit turk dhe në fushat e synuara të zhvillimit, si: besimi, gjuha, tradita dhe zakonet, shkenca, arti, arsimiti, kultura, zhvillimet politike.

### **Neni 6**

Organet e partisë dhe struktura e tyre janë transparente.

Veprimtaria e informimit në parti është e vazhdueshme dhe ky informim realizohet nëpërmjet mjeteve elektronike dhe formave të tjera.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës mund të nxjerrë buletin e vet, ose të botojë mjete të tjera informative.

1. Baza e veprimtarisë e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës

### **Neni 7**

Raportet punuese të partisë janë transparente dhe bazohen në parime demokratike. Çdo anëtar ka të drejtë të japë rekomandime, të vërë në rend dite çdo çështje dhe në mënyrë të lirë të shprehë mendimin e tij. Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës për Drejtësi obligohet t'i marrë parasysh rekomandimet dhe iniciativat e anëtarëve të vet. Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës vepron në bazë të parimeve të Programit dhe të Statutit të partisë.

Vendimet e miratuara në Këshillin Qendror Drejtues dhe zbatimi i rezultateve vlejné për të gjithë anëtarët.

Vendimet në Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës për Drejtësi merren me shumicë votash të pjesëmarrësve në takim.

### iii. DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E ANËTARËVE

#### **Neni 8**

Çdo qytetar i moshës mbi 18 vjeç, i cili e pranon Statutin dhe Programin e partisë dhe i cili nuk është i regjistruar si anëtar i ndonjë partie tjetër, mund të anëtarësohet në Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës. Çdo person që aplikon për anëtarësim në Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, duhet ta plotësojë formularin për anëtarësim në parti, i cili shqyrtohet nga dega e partisë dhe, pasi të miratohet, anëtarësia fitohet me nënshkrim.

#### **Neni 9**

Detyrat dhe të drejtat e anëtarit të Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës janë:

- Të kontribuojë në realizimin e vendimeve, të Statutit dhe të Programit të Partisë Turke të Kosovës;
- Të paraqesë kandidatë për organet e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , të votojë dhe të angazhohet për votim të kandidatëve;
- Të marrë pjesë në procese të vendimmarrjes të Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ;
- Të vëzhgojë aktivitetin e përfaqësueseve të zgjedhur nga partia;
- Të informohet për të gjitha aktivitetet e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ;
- Të përkrahë programin zgjedhor dhe kandidatët e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ;
- Të paguajë anëtarësinë e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës .

#### **Neni 10**

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, krahas anëtarëve të regjistruar, mund të ketë edhe anëtarë nderi. Anëtarë nderi janë personat që i kanë dhënë kontribut të veçantë Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës dhe ata zgjidhen me shumicë votash nga Këshilli Qendror Drejtues.

Një person, i cili është zgjedhur ose është emëruar nga partia në një post, nuk ka të drejtë të zgjidhet në një detyrë tjetër.

#### **Neni 11**

Largimi nga anëtarësia e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës përfundon me dorëheqjen nga anëtarësia.

Anëtarët që duan të dalin nga anëtarësia e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , duhet t'i drejtohen me shkrim degës ose Këshillit Qendror Drejtues.

Nëse një anëtar vepron në kundërshtim me Statutin dhe me Programin e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, largohet nga partia me vendimin e Këshillit Qendror Drejtues, në bazë të kushteve të përcaktuara me Statut dhe për shkaqet e cekura në vendimin për përjashtim.

#### **IV. ORGANIZIMI I Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës**

##### **Neni 12**

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës është parti e organizuar në gjithë Kosovën.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës mund të themelojë degët e veta.

Për themelimin e një dege, nevojitet vendimi i Këshillit Qendror Drejtues.

##### **Neni 13**

Regjistrimin e anëtarëve të Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës e kryejnë degët.

Degët vazhdimisht e informojnë Këshillin Qendror Drejtues për anëtarët e tyre.

#### **V. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DEGËVE**

##### **Neni 14**

Degët obligohen të respektojnë Programin dhe Statutin e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës . Nëse degët gabojnë në vendimmarrje dhe nëse për një

kohë të caktuar nuk e korrigojnë gabimin e bërë, vendimet e degës nuk miratohen nga Këshilli Qendror Drejtues.

### **Neni 15**

Organet e degëve janë:

- Kuvendi i degës;
- Këshilli drejtues;
- Kryetari i degës.

### **Neni 16**

Kuvendet dhe këshillat drejtuese të degëve zgjidhen me shumicë votash në Kuvendin zgjedhor të partisë, dhe caktohet numri i anëtarëve të këshillave.

Mandati i anëtarëve të kuvendeve të degëve dhe të këshillave drejtuese zgjat tri vjet nga momenti i zgjedhjes, me të drejtë rizgjedhjeje.

Mandati i kryetarit të partisë si dhe i kryetarëve të degëve zgjat 36 muaj, paralelisht me zgjedhjet partiake, dhe me mundësi të një rizgjedhjeje.

### **Neni 17**

Këshilli Qendror Drejtues, me 2/3-tat e votave, mund të shkarkojë anëtarin, i cili, pa arsyetim, 5 herë nuk merr pjesë në mbledhje, dhe me 2/3-tat e votave mund të emërojë anëtarin e ri, duke mos e pritur Kuvendin zgjedhor të partisë.

### **Neni 18**

Këshillat drejtuese të degëve mund të themelojnë komisione të ndryshme, si: Forumin Rinor (deri në moshën 27-vjeçare), Forumin e Grave, nëndegët dhe komisionet e ndryshme të nevojshme.

### **Neni 19**

Mbikëqyrja e degëve

Komisionet disiplinore dhe mbikëqyrëse të degëve përbëhen nga 3 anëtarë, të cilët zgjidhen nga këshillat drejtuese të degëve, me shumicë votash, dhe mund të shkarkohen, po me shumicë votash, nëse nuk veprojnë në mënyrë aktive.

Këto komisione, po qe se shfaqet nevoja, nga të emëruarit në instanca shtetërore në bazë të koalicioneve të përcaktuara nga degët mund të kërkojnë që ta informojnë udhëheqjen e partisë dhe të kërkojnë përgatitjen e raporteve punuese nga të emëruarit në fjalë.

#### **Neni 20**

Këshilli Qendror Drejtues mund t'i shkarkojë anëtarët joaktivë të Këshillit dhe, në një kohë të caktuar, degët mund të propozojnë anëtarët e rinj të Këshillit. Këto vendime merren me 2/3-tat e votave.

#### **Neni 21**

Po qe se kryetari i Këshillit Drejtues të Degës, ose nënkryetarët, nuk i mbajnë mbledhjet me rregull, kryetari i partisë, ose nënkryetarët e tij, mund të thërrasin mbledhjen e Këshillit të Degës.

#### **Neni 22**

Degët veprojnë me simbolet dhe me vulat e parapara në Statutin e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës .

#### **Neni 23**

Këshillat drejtuese të degëve mund të përbëhen nga 5 deri në 25 anëtarë.

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e vet të parë, zgjedh kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe arkëtarin.

### **VI. ORGANET QENDRORE TË PARTISË E TURKE DREJTËSISË SË KOSOVËS**

#### **Neni 24**

Organet qendrore të Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës janë:

- Kuvendi Qendror Partiak;
- Këshilli Qendror Drejtues;
- Kryetari i partisë;
- 3 nënkryetarë.



## a) KUVENDI QENDROR PARTIAK

### **Neni 25**

Kuvendi Qendror Partiak përbëhet prej delegatëve të zgjedhur nga degët.

Kuvendi Qendror përbëhet nga 51 anëtarë. Degët janë në: Prizren, Mamushë, Prishtinë, Vushtrri, Gjilan, Mitrovicë, Dobërçan dhe Janjevë. Numri i delegatëve të deleguar nga degët përcaktohet prej numrit të anëtarëve të regjistruar në degë dhe sipas kushteve aktuale të degëve. Po qe se shfaqet nevoja, mund të themelohen edhe degët të reja në vendbanimet e tjera të Kosovës.

### **Neni 26**

Kuvendi Qendror Partiak mbahet gjashtë (6) muaj nga dita e regjistrimit në KQZ

Kuvendi Qendror Zgjedhor i KATP është kuvend i rregullt dhe thirret **çdo tri vite (çdo 36 muaj).**

Kuvendi i punës mund të mbahet sipas nevojës.

Në mbledhjet e Kuvendit Qendror Partiak shqyrtohen synimet, përgjegjësitë, shpenzimet dhe të hyrat, shpalosen raportet buxhetore dhe raportet e punës, si dhe shqyrtohet dhe miratohet buxheti i vitit pasues.

Kuvendi Qendror Partiak mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme. Por, kjo ndodh vetëm me kërkesën e shumicës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit Qendror Partiak, ose me vendimin e Këshillit Qendror Drejtues.

Kur një vendim i tillë i paraqitet kryetarit të partisë, ose kur Këshilli Qendror Drejtues merr një vendim të tillë, kryetari i Partisë Turke të Kosovës mban mbledhje të jashtëzakonshme, cakton datën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes. Ky vendim duhet t'i komunikohet anëtarëve 7 ditë pune para mbledhjes.

Kuorumi i Kuvendit Qendror Partiak sigurohet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve.

Nëse nuk sigurohet kuorumi, mbledhja shtyhet për një datë tjetër dhe të gjithë anëtarët informohen për rendin e ri të ditës.

Nëse mbledhja nuk mund të realizohet edhe për dy herë, atëherë organizohen zgjedhjet e jashtëzakonshme partiake.

Çdo anëtar i Kuvendit Qendror Partiak ka të drejtë për një votë.

Vendimet në Kuvendin Partiak merren me shumicë votash të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.

### **Neni 27**

Krahas përgjegjësiave të përcaktuara me Statut, Kuvendi Qendror Partiak ka edhe këto autorizime:

- Me votë të mbyllur zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Qendror Drejtues, kryetarin dhe nënkryetarët;
- Kuvendi Qendror Partiak mund të marrë vendim edhe për votim të hapur;
- Voton Programin dhe Statutin e partisë dhe bën ndryshime dhe plotësime në to;
- Kryen punët e parapara me Statut, me Program dhe me dokumente të tjera.

### **Neni 28**

Mbledhjet e Kuvendit Qendror Partiak i kryeson kryetari i partisë dhe, në mungesë të tij, mbledhjet i kryeson njëri prej nënkryetarëve.

#### **b) KËSHILLI QENDROR DREJTUES**

### **Neni 29**

Këshilli Qendror Drejtues është organ i përbashkët dhe ekzekutiv i Kuvendit Partiak. Ky organ ekzekutiv zgjedh sekretarin e përgjithshëm, arkëtarin dhe zëdhënësin e tij.

### **Neni 30**

Kuvendi Qendror Partiak, me vendimin e vet, cakton numrin e anëtarëve të Këshillit Qendror Drejtues. Numri i anëtarëve duhet të jetë në proporcion me degët dhe çdo degë duhet të përfaqësohet me, së paku, një anëtar.

Personi që është anëtar i Këshillit Qendror Drejtues, në të njëjtën kohë nuk mund të jetë edhe anëtar i një partie tjetër.

### **Neni 31**

Mandati i kryetarit dhe i nënkryetarëve të Këshillit Qendror Drejtues zgjat tri vjet, me mundësi të një rizgjedhjeje.

### **Neni 32**

Këshilli Qendror Drejtues kryen këto detyra:

- Mban mbledhjet e zakonshme dhe, në rast nevojë, mund të organizojë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit Partiak;
- Zbaton politikat e caktuara nga Kuvendi Partiak dhe i realizon vendimet e Kuvendit;
- Shqyrton propozimet për ndryshime dhe plotësime në Statut dhe, deri në mbledhjen pasuese, përkohësisht mund t'i zbatojë ndryshimet dhe plotësimet në fjalë;
- Cakton rregulloret e punës;
- Analizon dhe miraton bilancin vjetor;
- Bashkëpunon me shoqata dhe me organizata, si dhe me partitë e tjera në Kosovë dhe jashtë saj, dhe merr vendime;
- Cakton çmimin për anëtarësi dhe bën distribuimin nëpër degë;
- Merr vendime për shfrytëzimin dhe për distribuimin e fondeve të Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ;

- Merr vendime për themelimin e degëve dhe të nëndegëve dhe veprimtarinë e tyre e integron me Statutin, me Programin dhe me dokumentet e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ;
- Cakton numrin e anëtarëve të partisë, të cilët punësohen në institucione dhe në organe të tjera;
- Shqyrton dokumentet e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, numrin e anëtarëve dhe siguron librezat e anëtarësisë;
- Publikon informata të ndryshme dhe kryen veprimtari të tjera.

### **Neni 33**

Plotësimi dhe ndryshimi i Programit dhe i Statutit të Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës iniciohet me kërkesën me shkrim të së paku një dege, ose me nënshkrimet e njëqind anëtarëve të partisë.

Kurse, Këshilli Qendror Drejtues i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , më së voni brenda një muaji, vë në rend dite iniciimin e plotësimit dhe të ndryshimit të Programit dhe të Statutit.

Pasi Këshilli Qendror i Partisë të ketë miratuar propozimin për plotësim dhe ndryshim të Programit dhe të Statutit të partisë, vendimin përfundimtar e merr Kuvendi Qendror i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës .

Para se të merret vendimi përfundimtar nga Kuvendi Qendror i Partisë Turke të Kosovës, duhet të merret edhe mendimi i Komisionit Statutor.

### **Neni 34**

Këshilli Qendror Drejtues i merr vendimet me shumicë votash të pjesëmarrësve.

Vendimet e Këshillit Qendror Drejtues mbahen sipas nevojës.

## c) KRYETARI I PARTISË

### **Neni 35**

Kryetari i Këshillit Qendror Drejtues është njëkohësisht edhe kryetar i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës

Kryetari i partisë i cakton mbledhjet e Këshillit Qendror Drejtues dhe udhëheq me aktivitetet e Këshillit Qendror Drejtues.

Kryetari i Partisë mund t'i zgjedh këshilltarët e tij politikë.

Kur kryetari i partisë nuk merr pjesë në mbledhje, atë e udhëheq njëri nga nënkryetarët.

### **Neni 36**

Detyrat e kryetarit të partisë janë:

- Thërret mbledhjet e Kuvendit Partiak dhe të Këshillit Qendror Drejtues;
- Përfaqëson Partine Turke e Drejtësisë së Kosovës , në emër të saj, nënshkruan kontrata, marrëveshje dhe vendime të tjera;
- Kur është e nevojshme, me zëdhënësin organizon takim për medie;
- Mbikëqyr aktivitetet e degëve dhe nëndegëve;
- Nënshkruan dokumentet fiskale për mënyrat e ndryshme të pagesës;
- Kryen edhe punë të tjera të parapara me Statut, me Program dhe me dokumente të tjera.

### **Neni 37**

Kryetari i Këshillit Drejtues, nënkryetarët dhe anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues mund të shkarkohen për këto shkaqe:

- Kur emërohen në institucione që nuk kanë të bëjnë me anëtarësi partiake;
- Kur fyejnë nderin e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ;
- Kur ndërmarrin iniciativa në kundërshtim me Statutin dhe me Programin e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ;
- Në rast të shkeljes së rëndë të përgjegjësive dhe të të drejtave të parapara në Statut;
- Në rast të dënimit me burg, për 6 muaj ose më shumë;
- Nëse me qëllim i shkaktojnë dëme materiale Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës ;
- Në kushte të njëjta shkarkohen edhe kryetarët e degëve, nënkryetarët dhe anëtarët e degëve.

### **Neni 38**

Nëse kryetari i partisë për shkaqe të ndryshme nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë mbledhjen e udhëheq njëri prej nënkryetarëve.

## §VII. KËSHILLAT DISIPLINOR DHE MBIKËQYRËS

### **Neni 39**

#### 39.1 Këshilli Disiplinor

Këshilli Disiplinor zgjidhet nga Kuvendi Partiak dhe përbëhet nga tre anëtarë.

Njëri prej anëtarëve është kryetar i Këshillit.

Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat tri vjet, me mundësi rizgjedhjeje.

#### 39.2 Këshilli mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës zgjidhet nga Kuvendi Partiak dhe përbëhet nga tre anëtarë.

Njëri prej anëtarëve është kryetar i Këshillit.

Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës para Kuvendit Qendror dhe i raporton atij, dhe i njëjti kontrollon të hyrat financiare të KATP\_së, shpërndarjen e tyre dhe menaxhon me pronën në shfrytëzim të KATP\_së.

Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat tri vjet, me mundësi rizgjedhjeje.

Këshilli Disiplinor dhe ai Mbikëqyrës kanë të drejtë të kërkojë raport nga kryetari i partisë, nga nënkryetarët dhe të mbikëqyrë ata.

## VIII. KOMISIONI PËR DORËZIM-PRANIMIN E DETYRËS

### **Neni 40**

Ky komision i kryen punët e dorëzimit-pranimi.

## IX. PJESËMARRJA NË ZGJEDHJE

### **Neni 41**

Vendimin për pjesëmarrje në zgjedhje të Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës për e merr Këshilli Qendror Drejtues.

Këshilli Qendror Drejtues cakton metodën dhe kriteret e pjesëmarrjes në zgjedhje.

### **Neni 42**

Të gjitha kuvendet e degëve, me shumicën e anëtarëve të pranishëm, mund t'i propozojnë Kuvendit Qendror së paku nga një kandidat për deputet në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare.

Renditjen në listë të kandidatëve të propozuar e miraton Këshilli Qendror Drejtues i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, me shumicë votash të pjesëmarrësve në mbledhje.

Gjatë renditjes së kandidatëve në listat zgjedhore, duhet të merren parasysh rezultatet e dy zgjedhjeve të fundit.

Anëtari i partisë, i zgjedhur për deputet ose i emëruar në poste shtetërore nëpërmjet partisë, obligohet ta informojë dhe t'i raportojë Këshillit Qendror Drejtues të Partisë, kur të kërkohet nga ky këshill.

Këshilli Drejtues i Partisë, anëtarin të cilin e vlerëson jo të suksesshëm nga aspekti i përfaqësimit të partisë, mund të mos e emërojë për kandidat në zgjedhje.

#### **Neni 43**

Çdo degë që vendos të marrë pjesë në zgjedhjet lokale, i cakton me shumicë votash kandidatët e vet.

#### **Neni 44**

Këshilli Qendror Drejtues i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës i cakton metodat dhe kriteret e pjesëmarrjes në zgjedhje të përgjithshme dhe lokale për kandidatët e vet, duke u bazuar në rregullat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në vendimet e Këshillit Qendror Drejtues të Partisë.

#### **Neni 45**

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës mund të marrë pjesë në zgjedhje edhe në koalicion me parti të tjera.

Me partinë ose me partitë me të cilat hyn në koalicion për zgjedhje, duhet paraprakisht të bëhet marrëveshje për koalicion.

Marrëveshja për koalicion bëhet e vlefshme kur të miratohet nga Këshilli Qendror Drejtues i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës .

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, duke marrë parasysh Statutin, Programin dhe interesat partiake, në zgjedhje lokale, në bazë të interesave të degëve sipas vendbanimeve ku ndodhen, mund të hyjë në koalicion me parti të ndryshme. Por, për këtë, duhet të informohet Këshilli Qendror Drejtues.

#### **Komisioni Statutor**



## **Neni 46**

Është një komision i përbërë nga tre anëtarë. Këtë komision e zgjedh Kuvendi Qendror i Partisë, në bazë të propozimit të Këshillit Qendror Drejtues të Partisë Turke të Kosovës. Njëri nga anëtarët bëhet kryetar i Komisionit.

Mandati i anëtarëve të Komisionit Statutor zgjat tri vjet, me mundësi rizgjedhjeje.

Komisioni Statutor i shqyrton kontestet statutore të partisë dhe bën interpretimin e Statutit.

Raportin e Komisionit Statutor e shqyrton Këshilli Qendror i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , dhe merr vendime për të.

## **X. PASURITË DHE BURIMET E PARTISË TURKE E DREJTËSISË SË KOSOVËS**

### **Neni 47**

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës është parti politike jofitimprurëse. Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, të ardhurat, fondet dhe dhurimet do t'i shfrytëzojë për qëllime jofitimprurëse. Asnjëri nga udhëheqësit e Partisë nuk mund t'i shfrytëzojë këto për t'i siguruar privilegj ndonjë anëtar, donatori ose ndonjë zyrtari. Të ardhurat e partisë rregullohen sipas Ligjit për financimin e subjekteve politike (Nr. 03/L-174).

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës të hyrat do ti kontrollon përmes hapjes së një xhirollogarie ne emer te partisë në nje nga bankat e Kosoves .

## **XI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 48**

Statuti i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës zbatohet si organ i veprimtarive të degës.

## **Neni 49**

Anëtari i cili nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, propozimet për rendin e ditës mund t'i dërgojë nëpërmjet mjeteve elektronike, ose në formë të dokumentit të shtypur.

## **Neni 50**

Nëse nuk realizohen përgjegjësitë dhe synimet e parapara me Programin dhe me Statutin e Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës, me votat e 2/3-tave të anëtarëve të Kuvendit Partiak, merret vendimi për shuarje.

## **Neni 51**

Bashkimi i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës me ndonjë parti tjetër mund të realizohet në bazë të vendimit përfundimtar të Kuvendit Qendror të Partise Turke e Drejtësisë së Kosovës , i cili merret në bazë të propozimit nga Këshilli Qendror Drejtues i partisë.

## **Neni 52**

Nëse Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës pushon së vepruari, pasuritë, mjetet financiare dhe fondet e mbetura pas shlyerjes së të gjitha borxheve sipas Ligjit për financimin e subjekteve politike dhe rregullave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rregullohen sikurse është paraparë me dispozitat ligjore në fuqi.

**Më 20.04.2021**

**Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës**

**M a m u ş a**